	<b>Totali për shërbime mallra dhe komunali</b>	<b>994,600.44</b>	<b>1,440,205.95</b>	<b>445,605.51</b>
22200	Subvencione dhe transfera	135,182.60	258,359.00	123,176.40
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>135,182.60</b>	<b>258,359.00</b>	<b>123,176.40</b>
31000	Investime Kapitale	1,463,345.99	1,665,006.68	201,660.69
	<b>Tatali i investimeve kapitale</b>	<b>1,463,345.99</b>	<b>1,665,006.68</b>	<b>201,660.69</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>8,499,133.51</b>	<b>9,389,476.27</b>	<b>890,342.76</b>

Komente:

Shpenzimet në vitin 2022 ne total janë 9.389.476,27€, Ndersa Shpenzimet ne vitin 2021 kane gene 8.499.133,51€

Shpenzimet në vitin 2022 janë më të larta në total për 890.342,76€ në krahasim me të njëjten periudh të vitit 2021

Në shpenzime janë përfshi pagat dhe medijet, shërbime mallra dhe shpenzimet komunale, subvencione dhe transfera dhe investime kapitale

Shpenzimet për Paga dhe medijet të vitit 2022 janë më të larta për 119.900,16€ në krahasim me vitin 2021

Shpenzimet për shërbime mallra dhe komunali të vitit 2022 janë më të larta për 445.605,51€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2021

Shpenzimet për subvencione dhe transfera të vitit 2022 janë më të larta për 123.176,40€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2021

Shpenzimet për Investime kapitale të vitit 2022 janë më të larta për 201.660,69€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2021,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Priljeno lidhësa			
14-10-2022			
Nat. organit Organi	Nomen/Drej.	Shtetësi Prilog	Vlera Mëdhenësi

02-035/02-1161



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkronja I të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, në harmoni me nenin 30 paragrafi I të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë;

### PROPOZIM VENDIM

**Për miratimin e Draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti.**

#### Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë miratimin e Draft Marrëveshjen ndërmjet Kolegjit UBT, dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti.

#### Neni II

Rezultatet kryesore të bashkëpunimit janë të cekura në detaje në Draft Marrëveshjen ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti.

#### Neni III

Palët kanë arritur ujdë me njëri tjetrin për përgatitjen e Draft Marrëveshjen ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti.

#### Neni IV

Pagesa bëhet nga buxheti i Komunës së Vitisë, te cilat pagesa i ekzekuton Drejtoria për Financa, ndërsa për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.


#### Neni V

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti





## **DRAFT- MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

### **NDËRMJET**

### **KOLEGJIT UBT**

### **DHE**

### **KOMUNËS SË VITISË**

### **PËR HARTIMIN E "HARTËS ZONALE TË KOMUNËS- VITI"**

**DUKE PASUR PARASYSH QË**, Kolegji UBT (më tutje referuar si "UBT") është një institucion privat i arsimit të lartë i themeluar në Prishtinë në vitin 2004, me lincencë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr. 808 / 02-1. Ai synon të ofrojë arritjet më të fundit në shkencën e menaxhimit, përsosmërinë e biznesit, teknologjinë moderne, robotikën, arkitekturën, dizajnin, planifikimin hapësinor, marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacinë, drejtësinë, shkencat shëndetësore etj. përmes programeve të tij ndërdisiplinore dhe inovative;

**DUKE PASUR PARASYSH QË**, Komuna e Vitisë, Kosovë, e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (më tutje referuar si "**Komuna e Vitisë**"), është e angazhuar të ndërmarrë veprime që çojnë drejt zhvillimit dhe menaxhimit hapësinor dhe urbanistik të përmirësuar dhe të ndjeshëm ndaj mjedisit, të rregullojë dhe forcojë strukturat organizative të përshtatshme për planifikim strategjik dhe pjesëmarrës, si dhe të planifikojë zbatimin, përmirësimin e dialogut publik, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe bashkëpunimin ndër-komunal në mbështetje të kushteve të përmirësuara të jetesës dhe zhvillimit gjithëpërfshirës;

**BAZUAR NË** dispozitat ligjore neni 30 paragrafi 1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale **NR.03/L-040**;

**DERISA**, UBT dhe Komuna e Vitisë kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në hartimin e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë;

**DERISA**, projekti Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë do të mbledhë ekspertë dhe profesionistë me përgatitje të ndryshme akademike e profesionale, të cilët në bashkëpunim me Grupin Punues Bazë të Projektit (të përbërë nga stafi i UBT-së ,zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të komunitetit dhe shoqërisë civile, siç paraqitet në Shtojcën B: Grupi Punues Bazë) dhe komunitetin do të punojnë për hartimin e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë;

**DERISA**, UBT dhe Komuna e Vitisë (më tutje referuar kolektivisht si "**Palët**" dhe individualisht si "**Pala**") që njohin përfitimet e një bashkëpunimi të mirëfilltë, thelbësor dhe që dëshirojnë të ndjekin një bashkëpunim të tillë kanë hyrë në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tutje referuar si "**MB**") në një frymë besimi dhe bashkëpunimi;

Palët bien dakord si më poshtë:

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### NENI I

#### Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të sigurojë një kornizë bashkëpunimi brenda së cilës UBT dhe Komuna e Vitisë hartojnë së bashku Hartën Zonale Komunale dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për Komunën e Vitisë.
2. Bashkëpunimi midis Palëve në Viti, Kosovë do të implementohet me fokus në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe programi për zhvillim të gjithëmbarshëm e të qëndrueshëm të komunës.
3. Rezultatet kryesore të bashkëpunimit janë si në vijim:
  - (a) Involvimimi i stafit akademik dhe profesional të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), përfitimi nga njohuritë dhe eksperiencat e tyre për të zhvilluar strategji të mirëfillt, e bazuar në praktika të mira globale dhe në nevoja/kërkesa lokale, për t'i dhënë komunës së Vitisë kahje drejt zhvillimit të qëndrueshëm,
  - (b) Hartimi i Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës,
  - (c) Harmonizimi i Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë me dokumentet relevante të Zhvillimit Hapësinor të Kosovës, të parapara me **Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor**, si dhe me të gjitha dokumentet tjera relevante që janë aktualisht në zbatim, si dhe me ato të planifikuara, në komunën e Vitisë,
  - (d) Përfshirja e Hartës Zonale Komunale për Komunën e Vitisë dhe programit dhe planeve të veprimit brenda agjendës së zhvillimit të Komunës së Vitisë (dokumentet e planifikimit hapësinor, strategjitë e zhvillimit dhe ciklet e buxhetimit).

### NENI II

#### Përgjegjësitë e Përgjithshme të Palëve

1. Palët do ta mbajnë njëri-tjetrin të informuar për të gjitha aktivitetet përkatëse që i përkasin kësaj Marrëveshje dhe do të zhvillojnë konsultime në çdo kohë që Palët e konsiderojë të nevojshme.
2. Palët do të përmbahen nga çdo veprim që mund të ndikojë negativisht në interesat e Palës tjetër dhe do të përmbushin zotimet e tyre duke i respektuar plotësisht termat dhe kushtet e kësaj MB.
3. Secila palë duhet të emërojë një person kryesor kontaktues për këtë bashkëpunim siç përcaktohet në **Nenin VIII ("Njoftimet")**, **klauzola (1)** këtu e më poshtë.
4. Palët bien dakord që kjo MB përmbanë edhe detyrime financimi për palët. Kosto totale e projektit është 145,000.00 (Njëqind e Dyzetepesë Mijë) Euro. Nga kjo kosto 70,000.00 (Shtatëdhjetë Mijë) Euro (48.3 % e shumës totale) do të mbulohet nga Komuna e Vitisë. Ndërsa pjesa tjetër prej 75,000.00 (Shtatëdhjetë e Pesë Mijë) Euro (51,7 % e shumës totale) do të mbulohet nga UBT. Parimet e përgjithshme të pagesës për Komunën e Vitisë janë specifikuar në **Kushtet e Veçanta** të kësaj MB.



**NENI III**  
**Fushat e Bashkëpunimit në Mes të Palëve**

- I. Palët do të bashkëpunojnë në hartimin e Hartës Zonale Komunale si dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, përfshirë:
  - (a) Shkëmbimin dhe/apo shpërndarjen e të dhënave dhe materialeve të nevojshme për fazën analitike si dhe për fazat e përgaditjes së skenarëve zhvillimor,
  - (b) Dhënien e komenteve në lidhje me drejtimit e zhvillimit të qëndrueshëm hapsinorë, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës të Vitisë,
  - (c) Asistimin në zhvillimin dhe organizimin e punëtorive dhe takimeve me komunitetin,
  - (d) Pjesëmarrjen në punëtoritë e organizuara dhe në takime të ndërlidhura me komunitetin,
  - (e) Asistim në organizimin e konferencave informuese që lidhen me projektin,
  - (f) Asistimin në procedurat administrative e burokratike që lidhen me projektin,

**NENI IV**  
**Përgjegjësitë e Veçanta të Palëve**

- I. Përgjegjësitë e veçanta të UBT-së janë:
  - (a) Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe organizative për hartimin e Hartës Zonale Komunale dhe Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Komunën e Vitisë, duke angazhuar staf akademik e profesional nga UBT- Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor si dhe nga fakultetet, qendrat e institutet relevante me natyrën e projektit,
  - (b) Ofrimi i mbështetjes logjistike (duke siguruar hapësirën, materialet përkatëse të nevojshme, printimin dhe pplotimin etj.),
  - (c) Organizimi i vizitave në terren,
  - (d) Organizimi i takimeve me komunitetin, në bashkëpunim me komunën e Vitisë,
  - (e) Organizimi i konferencave informuese lidhur me projektin,
  - (f) Promovimi i projektit dhe aktiviteteve të ndërlidhura me projektin.
2. Përgjegjësitë e veçanta të Komunës së Vitisë janë:
  - (a) Mbështetja e hartimit të Hartës Zonale Komunale dhe Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe udhëheqja drejt implementimit të suksesshëm të tij,
  - (b) Sigurimi i përfshirjes së zyrtarëve komunalë në kuadër të Grupit Punues Bazë të projektit,
  - (c) Koordinimi me Drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës për hartimin e Hartës Zonale Komunale dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
  - (d) Ndërmjetësimi në lidhjen me përfaqësuesit e komunitetit,
  - (e) Mundësimi i përdorimit të hapësirave të saj për zbatimin e punëtorive dhe takimeve që

- lidhen me projektin,
- (f) Ofrimi i mbështetjes logjistike,
  - (g) Ndërmjetësimi me Grupin Punues Bazë dhe të gjitha palët tjera të involvuara
  - (h) Promovimi i projektit dhe aktiviteve të ndërlidhura me projektin,
  - (i) Vendosja e një shembulli të mirë për hartimin dhe zbatimin e Hartës Zonale Komunale

## **NENI V**

### **Monitorimi dhe Vlerësimi**

1. Palët do të mbajnë konsultime të rregullta në baza mujore për të monitoruar dhe rishikuar përparimin e aktiviteve që janë paraparë me këtë MB.

## **NENI VI**

### **Ndërprerja**

1. Në rast të konstatimit se njëra nga palët nuk i ka përmbushur obligimet që dalin nga kjo Marrëveshje, Marrëveshja mund të përfundohet nga secila Palë duke i dhënë palës tjetër njoftimin me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë para qëllimit të tij për të përfunduar. Në rast të përfundimit, Palët do të ndërmarrin hapat e duhur për të sjellë aktivitetet nën këtë MB në një përfundim të shpejtë dhe të rregullt.

2. Përfundimi i kësaj Marrëveshje nuk do të cenojë asnjë marrëveshje tjetër tashmë të nënshkruar nga Palët.

## **NENI VII**

### **Forcat madhore**

1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas marrëveshjes nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore (fatkeqësi natyrore, epidemi, pandemi, trazira civile, mbyllje e objektit ose çrregullime tjera industriale dhe të ngjashme) që shkaktohet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj MB.
2. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detale mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë të kenë rrethanat.
3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arësishme për të mënjeluar paaftësinë për të përmbushur detyrimet e saj me vonesa minimale.

## **NENI VIII**

### **Ndryshimet**

1. Kjo MB mund të modifikohet me marrëveshje me shkrim midis Palëve të tij. Çfarëdo çështje e rëndësishme për të cilën nuk është bërë asnjë dispozitë në këtë MB do të zgjidhet nga palët në përputhje me objektivat e përgjithshëm të MB dhe në atë mënyrë që është e favorshme për vazhdimin e marrëdhënieve të mira.

**NENI IX**  
**Njoftimet**

1. Çfarëdo njoftimi që kërkohet të jepet nga ndonjëra Palë e kësaj MB do të jepet me shkrim dhe do të konsiderohet se jepet kur në të vërtetë pranohet nga Pala tjetër, në adresat e mëposhtme:

<b>Për UBT-në</b>	<b>Për Komunën e Vitisë</b>
<b><u>Për Çështje Operative:</u></b> Emri: Hazer Dana Titulli: Staf Akademik në UBT Adresa: Lagjja Kalabria, 10000 Prishtinë, Kosovo Numri i Telefonit: +383 44203500 Email Adresa: <a href="mailto:hazer.dana@ubt-uni.net">hazer.dana@ubt-uni.net</a>	<b><u>Për Çështje Operative:</u></b> Emri: Visar Demiri Titulli: Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit Adresa: Rruga 28 Nëntori, Viti, 61000, Republika e Kosovës Numri i Telefonit: +383 44 199 021 Email Adresa: <a href="mailto:visar.m.demiri@rks-gov.net">visar.m.demiri@rks-gov.net</a>

**NENI X**  
**Natyra Konfidenciale e Dokumenteve**

1. Informacioni që konsiderohet i zotëruar nga secila Palë dhe që është i ndarë ose i zbuluar palës tjetër, dhe është përcaktuar si konfidencial, do të mbahet me besim nga ajo Palë dhe do të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin u zbulua.

**NENI XI**  
**Hyrja në Fuqi**

1. Kjo MB hyn në fuqi në datën e miratimit në Kuvendin Komunal Viti dhe do të jetë efektive për periudhën deri në përfundimin e projektit, përveç nëse ndërpritet më herët nga ndonjëra Palë në përputhje me Nenin VI ("Ndërprerja") më sipër.
2. Kjo MB përmbanë edhe një Plan Dinamik të Punës që tregon afatet, metodat, aranzhimet, rendin dhe orarin për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me projektin.

**NENI XII**  
**E Gjithë Marrëveshja**

1. Kjo MB paraqet kuptimin e plotë të UBT-së dhe Komunës së Vitisë sa i përket temës kryesore të tij dhe i zëvendëson të gjitha komunikimet me gojë dhe dokumentet paraprake me shkrim.

**ME KËTË VËRTETOHET SE**, të nënshkruarit më poshtë, përfaqësuesit e autorizuar të UBT-së dhe Komunës së Vitisë, e kanë nënshkruar këtë MB në 2 (dy) kopje origjinale në vendin(et) dhe në datën(at) e shënuara më poshtë:

<b>Për UBT-në</b>	<b>Për Komunën e Vitisë</b>
<b>Prof.Dr. Edmond Hajrizi</b> President & Rektor i UBT-së	<b>z. Sokol Haliti</b> Kryetar i Komunës së Vitisë
<b>Vendi:</b> _____	<b>Vendi:</b> _____
<b>Data:</b> _____	<b>Data:</b> _____

## KUSHTET E VEÇANTA TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

- 1. Fillimi i Procesit:** Data e fillimit të procesit është 15.11.2022.
- 2. Përfundimi i Procesit:** Data e përfundimit të aktiviteteve të parapara me këtë MB është më së largu 18 muaj pas datës së fillimit të procesit.
- 3. Plani Dinamik i Punës:** Plani Dinamik i Punës është pjesë e kësaj MB (Shtojca B).
- 4. Zgjatja e periudhës së përfundimit:** UBT mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i obligimeve të dala nga kjo MB vonohet, ose pritet të vonohet, për njërin nga këto arsye:
  - a) Komuna e Vitisë ka dështuar t'i plotësoj obligimet e veta sipas Marrëveshjes,
  - b) Forca Madhore, siç është definuar në Nenin VII.
- 5. Konsekuencat e Shkeljes së Marrëveshjes:**

Pala ka shkelur Marrëveshjen nëse nuk arrinë t'i kryejë obligimet e parapara me këtë MB. Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) Mbulimi i dëmeve dhe/ose
- b) Ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

- 6. Parimet e përgjithshme të pagesës:** Pagesa nga ana e komunës së Vitisë do të bëhet në 4 faza:

Faza e parë: Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Vlera e saj duhet të jetë 20,000.00 (Njëzetmijë) Euro, apo 28.6 % e shumës totale të pagesës.

Faza e dytë: Jo më vonë se 60 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i fazës së Mbledhjes së të Dhënave. Vlera e saj duhet të jetë 15,000.00 (Pesëmbëdhjetë mijë) Euro, apo 21.4 % e shumës totale të pagesës.

Faza e tretë: Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i draftit të parë të HZK. Vlera e saj duhet të jetë 15,000.00 (Pesëmbëdhjetë mijë) Euro, apo 21.4 % e shumës totale të pagesës.

Faza e katërt: Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e pëlqimit nga MMPHI për draftin final të HZK dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Vlera e saj duhet të jetë 20,000.00 (Njëzetmijë) Euro, apo 28.6 % e shumës totale të pagesës.

- 6.1. Pagesa nga Komuna e Vitisë do të bëhet në xhirlogarinë e shënuar më poshtë:**

Emri i përfituesit:	UBT KNBT SHPK
Numri i llogarisë bankare	1300001500005275

## **7. Kontrolli i kualitetit**

Komuna e Vitisë do të kontrollojë punën dhe do t'a njoftojë palën tjetër (UBT-në) për çdo parregullësi të identifikuar. Kjo mund të ndodhë përgjatë gjithë procesit të punës si dhe për një periudhë Nëntëdhjetë (90) ditore pas përfundimit të aktiviteteve të parapara me këtë MB. UBT është e obliguar që të korrigjojë parregullsitë e identifikuara nga ana e Komunës në një afat të arësyeshem i cili nuk do të jetë më i gjatë se 30 ditë pas pranimit të rekomandimit/sygjerimit dhe/apo kërkesës nga ana e Komunës.

## **8. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

Palët janë pajtuar që çdo mosmarrëveshje së pari ta zgjidhin me bisedime në mënyrë verbal apo marrëveshje me shkrim.

## **9. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

Çdo mosmarrëveshje në mes të palëve e cila mund të lindë gjat implementimit të kësaj MB dhe e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, ajo do të dorëzohet në Gjykatën relevante me natyrën e kësaj MB.

**Shtojca A: Grupi Punues Bazë**


Anëtarët e Grupit Punues Bazë për bashkëpunim me UBT-në janë:

Komuna ka emëruar stafin e mëposhtëm për Grupin Punues Bazë të projektit Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë:

<b>Numri.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Departamenti</b>
1		
2		
3		
4		
5		

UBT ka emëruar stafin e mëposhtëm për Grupin Punues Bazë të projektit Harta Zonale Komunale për Komunën e Vitisë:

<b>Numri.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Departamenti</b>
1.	Prof.Dr. Edmond Hajrizi	UBT – Menaxhmenti i Lartë
2	Dr.Sc. Visar Baxhuku	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
3.	Dr.Sc. Hazer Dana	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
4.	Dr.Sc. Tomor Çela	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.
5.	BSc. Lyra Bakija	UBT – Instituti për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 17.10.2022, bën këtë :

### PROPOZIM VENDIM

**Paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër (nga 1-15 vite) të pronës së palujtshme të komunës përmes Ankandit Publik**

#### Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraparak, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00211-2, vendi i quajtur „Visoça“ me sipërfaqe prej 81412 m<sup>2</sup>,
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00211-4, vendi i quajtur „Visoça“ me sipërfaqe prej 206276 m<sup>2</sup>,
3. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00098-0, vendi i quajtur „Golesh“ me sipërfaqe prej 771703 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale në Devajë, komuna e Vitisë.

#### Neni 2.

Afati kohorë për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është afat shkurtër (nga 1-15 vite) përmes procedurave të ankandit publik, ku bëhet përzgjedhja e ofertave nga ana e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi Komunal.

#### Neni 3.

Qellimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik.

#### Neni 4.

Procedurat për dhënie e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

#### Neni 5.

Menyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfituesit marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejtë të shkeputjes së kontratës edhe para afatit nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

#### Neni 6.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Komisioni Vlerësues i Ofertave, Kryetarit i Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent ndërsa përndersa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesusi i Kuvendit Komunal në Viti.

#### Neni 7.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Devajë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70101018-00211-2	Parcelë / Parcela / Parcel	81412
P-70101018-00211-4	Parcelë / Parcela / Parcel	206276



Shkalla/Razmera/Scale: 1:8466

15/10/2022  
 Punoi/Obradi/Created:  
 Data/ Data/Date: 17.10.2022  
 Koha/ Vreme/ Time: 11:05:33  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:  
 Shënim/Beleška/Note:

Aprovoj/Usvojilo/Approved: Drejtori/Direktor/Director  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunaie/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Devajë


Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70101018-00098-0	Parcelë / Parcela / Parcel	771703



Shkalla/Razmera/Scale: 1:12582

*15/10/2022*  
 Punoi/Obradio/Created:  
 Data/ Data/Date: 17.10.2022  
 Koha/ Vreme/ Time: 11:03:51  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:  
 Shënim/Beleška/Note:

*[Handwritten Signature]*



Approv/Usvojto/Aproved: Drejtori/Direktor/Director  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vitisë

1511/2022

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

17.10.2022 - 11:00

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

VITI / VITINA / VITI

Opština / Municipality:

VITI / VITINA / VITI

Adresa e Kancelarisë / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

## TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizimit (biznesit) Prezime/ Naziv postovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj postovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit, Drzava drzavljanstva ili ukrajizhenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
Komuna e Vitisë			/	600424486	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		29.12.2020	

## 1. ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
/		28 NENTORI		



**NJESIA KADASTRALE/ KATASTRARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT**

Njesia kadastrale Katastrarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastrarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type  Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
0101018-00098-0	VITI / VITINA / VITI	Devajë / Devaja / Devajë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		GOLESH / GOLESH / GOLESH	771703	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 6 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
0101018-00211-2	VITI / VITINA / VITI	Devajë / Devaja / Devajë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		VISOÇA / VISOÇA / VISOÇA	81412	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 6 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
0101018-00211-4	VITI / VITINA / VITI	Devajë / Devaja / Devajë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		VISOÇA / VISOÇA / VISOÇA	206276	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 6 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	23.05.2018

COVES  
OSISE




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

14-10-2022

Princër - Priftërisë të Qendrës			
Nr. i organit Org. brej	Numri i broj	Ditë P. broj	Vlera Vendime?
	02-035/02-1163		



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 11, paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenin 20 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe Udhëzimin Administrativ të MMPI-II-së nr, 05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor, nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

## PROPOZIM VENDIM

### Për shqyrtim publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030

#### Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në shqyrtim publik Projekt Planin e Zhvillimit Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030.

#### Neni 2

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

- 2.1 Ekspozimi i projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës .
- 2.2 Për të promovuar gjithëpërfshirjen dhe transparencën do të mbahen edhe prezantime shtesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.
- 2.3 Për të gjitha prezantimet publike do të mbahet procesverbal.
- 2.4 Shqyrtimi publik i projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" zgjatë 30 (tridhjetë) ditë- sipas procedurave të përcaktuara me ligj.
- 2.5 Shpallja e shqyrtimit publik të projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe në mediat televizive publike dhe lokale.

#### Neni 3

3.1 Në Shqyrtimin Publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030".

3.2 Në Shqyrtimin Publik prezantohen fazat e projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030 " si .

- Informata mbi Kornizën Strategjike;
- Profili i Komunës;
- Vlerësimi i Gjendjes;
- Korniza e Zhvillimit Hapësinor;
- Plani i Veprimit
- Pjesa Hartografike;

3.3 Projekt "Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2022-2030 " është i qasshëm për Publikun në formë të shtypur dhe elektronike .

#### **Neni 4**

4.1. Projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2022-2030 ' i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sygjërimeve të publikut para se të finalizohet .

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sygjërimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

#### **Neni 5**

Shqyrtimi i Projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" organizohet nga Komuna e Vitisë në suaza të Kompetencave të Përcaktuara me Ligj.

#### **Neni 6**

6.1 Me këtë propozim vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së Shqyrtimit Publik të projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030".

6.2 Pjese përbërëse e këtij propozim vendimi është plani i Organizimit të Aktiviteteve gjatë kohës së Shqyrtimit Publik.

#### **Neni 7**

Me miratimin e këtij propozim vendimi shfuqizohet vendimi për shpalljen në shqyrtim publik të projekt "Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030" me Nr. 01-110/05-1061, i datës 29.09.2022.

#### **Neni 8**


Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij propozim-vendimi është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e komunës së Vitisë.

#### **Neni 9**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES: KRYETARI

Sefer



Plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik

Data	Bashkësia Lokale	Vendi	Aktiviteti
Dita 1	Viti	Salla e Kuvendit Komunal	Prezantimi dhe shqyrtimi publik
Dita 2	Këshilli Lokal Pozharan	Shkolla e Mesme -Pozharan	Prezantimi dhe shqyrtimi publik
Dita 3	Këshilli Lokal Smirë	Shkolla Filllore -Smire	Prezantimi dhe shqyrtimi publik
Dita 4	Këshilli Lokal Sllatinë e Epërme	Shkolla Filllore – Sllatinë e Epërme	Prezantimi dhe shqyrtimi publik
Dita 5	Këshilli Lokal Gjylekarë	Shkolla Filllore – Gjylekar	Prezantimi dhe shqyrtimi publik
Dita 6	Këshilli Lokal Stubell	Shkolla Filllore - Stubell	Prezantimi dhe shqyrtimi publik






REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Priliceno (Çelësno) <i>14-10-2022</i>			
Nr./I organit Org.broj	Komuna/Etoj	Shikues Paloq	Vlera Vendimet
<i>01-016/01-1160</i>			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republik of Kosovo**

**Komuna e Vitisë**  
**Opstina Vitina-Municipality of Vitina**



ZYRA E PROKURIMIT

**Për: Komitetin për Politikë dhe Financa**

## INFORMATË E PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA PËR NËNTËMUJORIN 2022

(JANAR-SHTATOR 2022)

Tetor 2022

Kjo informatë ka të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotsimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtjes pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi, këto aktivitete Zyra i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Informatë për aktivitetet e prokurimit 9 muhor për vitin 2022, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë nëntëmujor.

Në nëntë mujorin e vitit 2022, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese zyra ka inicuar 62 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna;

18 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime,

14 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe

30 me lëndë prokurimi Furnizime.

Nga këto aktivitete, 46 janë përbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon:

42 raste është përdorë procedura e hapur,

18 raste procedura e kuotimi i çmimit,

1 aktivitete procedurë me Vlera minimale, dhe

1 aktivitete mini procedura

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 46 aktivitete të prokurimit, janë përbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; 16 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Zyra e prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka nxjerr Urdhërblertet për Operatoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 7,766,408.42 €.

Zyra e prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar 733 Urdhërblerja për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësishte ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe 142 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera.


Gjithashtu duhet potencuar se Zyra e prokurimit në nëntë mujorin e parë, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Menaxheri i zyrës së prokurimit





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Vitisë**  
**Opstina Vitina-Municipality of Vitina**



**INFORMATË PË KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA**

*forn nenit 87.2.9.12 të Ligjit Nr. 04/L042, Ligji për Prokurimin Publik në Kos*

Data e përgatitjes së raportit:	13.10.2022	Viti fiskal	2022
---------------------------------	------------	-------------	------

**PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	KOMUNA E VITISË		
Lloji i Autoritetit Kontraktues (zgjidhëne njëren)			
Kodi buxhetor			
Adresa	Vi657		
Kodi postar - Qyteti	Viti, rruga "28 Nëntori"		
Tel. fiks/Celulari /Faksi	61000 Viti		
Emri i menaxherit të prokurimit	0280/381 519	044 505 984	
E-mail adresa	Fadil ABAZI		
Adresa e webit të AK	fadil.n.abazi@rks-gov.net		
	kk.rks-gov.net/viti/		

**PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE**

Nr. i Prokurimit	Numri rendor i prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 sifrat e para të FPP)	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashkuar e kontratës (zotimit)	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Selia e OE të cilit i është dhënë kontrata	OE vENDOR (1) ; Jo vendor (2)		
													Ata kohor normal (1)	Ata kohor i shkurtuar (2)	Çmimi më i ulët (1)
2	3	4	5	6	7	8	9.00	10.00	11	12	13	14	15	16	
001	1	2	1	23		Furnizimi me derivate të naftës për të gjitha njësitë shpenzuese	24.02.2022	82,400.00	82,400.00	0.00	HIB PETROLL SH.P.K	Prishtine			
002	1	2	1	17		Furnizimi me perde tepih dhe tepison për nevojat e shkollave dhe administratës komunale	09.06.2022	32,000.00	31,600.00	0.00	IBM SHPK	Mitrovica			
003	5	3	6	45		Rregullimi i ventilimit në dhomën e Ngrohjes qendrore në objektin e Komunës së re	25.02.2022	7,500.00	3,998.88	0.00	EKOTERMIKA SH.P.K	Suhareke			
004	2	3	6	29		Shërbimet e servisimit të digjitalizimit	05.04.2022	8,000.00	7,900.00	0.00	NPT MEDICA	Prishtine			
005	2	3	6	63		Shërbimet e sigurimit TPL, TPL+, dhe KASKO për automjetet e komunes së Vitisë	07.03.2022	9,950.00	8,983.13	0.00	EUROSIG SH.A	Prishtine			
006	2	1	1	93		Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-palativ i të smuarëve në Komunën e Vitisë-dy vjeçar	01.07.2022	700,000.00	700,000.00	0.00	CARITAS KOS	Ferozaj			
007	1	1	1	2		Furnizim me dru zjarrri për djegie për të gjitha njësitë shpenzuese	07.04.2022	319,400.00	319,400.00	0.00	NTSH DARDANI	Kaqanik			
008	1	2	1	01		Furnizim me fidane të arrës Chandler , dhe rezervuare për sistemin e ujitjes		14,426.25			ANULUAR				
009	1	2	1	01		Furnizimi me farë misri për nevojat e fermerëve		32,000.00			ANULUAR				

010	1	4	7	22	Furnizimi me dhurata për mësimdhënës për festën e 7 Marsit.	04.03.2022	999.00	987.50	0.00	VISUAL MEDIA	Viti			
011	1	2	1	33	Furnizim me pajisje mjekesore (aparatura medicinale)		21,000.00							
012	1	2	1	31	Furnizim , montimi dhe rregullimi me material te imet dhe paisje teknike per nevojat e te gjitha njesive shpenzuese	27.04.2022	45,600.00	73,914.40	0.00	AGROSODOVINA	Viti			
013	5	2	1	45	Renovimi i ambulantave- dy vjeçare	06.05.2022	172,000.00	141,129.75	0.00	LURN SHPK	Fushë Kosovë			
014	1	3	6	24	Furnizim me oksigjen medicinal	22.03.2022	3,000.00	1,864.40	0.00	NPT MEDICA	Prishtine			
015	2	3	6	33	Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve laboratorike	13.04.2022	6,000.00	5,996.00	0.00	BIO LAB SHPK	Gjilan			
016	1	3	6		Furnizim me dokumenta blanko per nevojat e QKMF-s	15.04.2022	7,102.50	9,119.00	0.00	AGIMI-DE	Prishtine			
017	1	3	6	02	Furnizim me pelet për QMF-n në Pozheran		11,000.00							
018	1	1	1	28	Furnizim me material të shtypur, material reklamues, të gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese-tre vjeçar	04.08.2022	178,104.00	178,104.00	0.00	VISUAL MEDIA+	Viti			
019	2	2	1	93	Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-palativ i të sëmurëve në Komunën e Vitisë	07.04.2022	69,900.00	69,900.00	0.00	C.I.K CARITAS	Ferizaj			
020	1	3	6	15	Furnizimi me pemë dhe perime. Mini procedurë. Numër.UA/2016-19-9623-1-1-1	26.04.2022	8,659.50	9,111.00	0.00	BRAHIM ZEQIRI B.I	Prishtine			
021	2	2	1	93	Shërbimet e mirëmbajtjes së ujësjellësve dhe kanalizimeve në Komunën e Vitisë	04.03.2022	36,000.00	36,000.00	0.00	VIZION BD	Viti			
022	1	3	6	28	Furnizim me foli të zezë për kultivuesit e shalqirit	29.04.2022	9,000.00	9,000.00	0.00	I.P.N EU SHPK	Prishtine			
023	2	2	1	22	Shërbimet e transportit me autobus për nevojat e Autoritetit kontraktues	07.06.2022	13,500.00	13,500.00	0.00	EUROTRANS	Viti			
024	2	3	6	29	Mirëmbajtja e aparateve te stomatologjisë	07.06.2022	3,922.50	2,987.95	0.00	PROMEDOCAL	Ferizaj			
025	1	2	1	17	Furnizim me rekuizita sportive për nevojat e Drejtorisë së Sportit dhe Drejtorisë së Arsimit	09.06.2022	13,700.00	9,499.00	0.00	INFINITT	Prishtine			
026	5	2	1	45	Rregullimi i hapësirave gjelbruese-publike		100,000.00							
027	1	3	6	29	Furnizimi me pajisje teknike për Çerdhën "Gëzimi Ynë"	13.07.2022	9,950.00	7,699.00	0.00	MULTI ENGINEERING	Prishtine			
028	5	2	1	45	Riparimet nëpër Shkollat e komunës së Vitisë	10.08.2022	316,000.00	213,845.46	0.00	EURO COMMERCE	Viti			
029	2	3	6	30	Mirëmbajtja e e-kioskut në Pozheran		4,000.00			ANULUAR				
030	5	2	1	45	Rregullimi i fushave sportive-dy vjeçar	12.08.2022	520,000.00	752,125.10	0.00	EURO COMMERCE	Viti			
031	5	2	1	45	Rregullimi i kanaleve dhe prockave në komunën e Vitisë	07.10.2022	120,000.00	117,645.00	0.00	VIZIONI BD-ATC COM	Viti			
032	1	2	1	29	Furnizim me pajisje për fikjen e zjarrit dhe këpuca për zjarrfikëst e njësisë në Viti	24.06.2022	5,765.00	4,900.00		AGRO KOMTEL	Prishtine			

033	5	1	1	45	Asfaltimi i rrugëve rurale- dy vjeçar	26.08.2022	1,299,973.00	1,299,973.00	0.00	PROCOGROUP	Prishtine			
034	2	1	1	74	Hartimi i projekteve investive për komunën e Vitisë- trevjeçar		300,000.00							
035	2	3	6	93	Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, aksesore dhe zërimet për nevoja e Autoritetit kontraktues	13.06.2022	7,220.00	3,258.20		KORABI	Gjilan			
036	2	2	1	92	Shërbimet e xhirimit dhe transmetimit televiziv për nevojat e Komunën e Vitisë dhe Kuvendit komunal- tre vjeçar		178,104.00							
037	1	2	1	7	Furnizimi i kabineteve shkollore me pajisje (video-projektor)	18.07.2022	36,000.00	35,980.00		TRIO TEK	Prishtine			
038	5	2	1	45	Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor- dy vjeçare	12.08.2022	620,000.00	611,849.93		PRO CO GROUP	Viti			
039	2	1	1	93	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së Hapsirave të Hapura Publike në komunën e Vitisë-dy vjeçar		440,000.00							
040	5	2	1	45	RREGULLIMI I OBJEKTIT PËR INKUBATOR BIZNESI	06.09.2022	494,253.00	521,755.00	1.00	AVAG GROUP	Gjilan			
041	1	3	6	30	Furnizimi me veshmbathje për nevojat e QKMF.s	16.06.2022	3,500.00	2,640.00	1.00	SANKOS	Kaçanik			
042	1	2	1	34	Furnizim me motokultivator për fermerët	18.08.2022	18,000.00	17,975.00	1.00	KOMTEL ENGINEERING	Prishtine			
043	1	3	5	33	Furnizimi dhe montimi i kamerave IP në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti	16.06.2022	5,700.00	2,977.00	0.00	INFINITT	Prishtine			
044	1	2	1	28	Furnizim me serra për fermerët e Komunës së Vitisë (50 m²)	29.8.2022	70,000.00	69,500.00	0.00	DST Produkt	Ferizaj			
045	5	2		45	Rregullimi i kanalizimeve në komunën e Vitisë- dy vjeçar	06.10.2022	450,000.00	410,587.64	0.00	ENBAU-VIZIONI ATC.COM	Viti			
046	5	2		45	Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaçanik- Faza e II (dytë).-Aneks	11.08.2022	188,780.71	188,780.71	0.00	PRO CO GOUP	Viti			
047	1	2	1		Furnizimi me Spërkatëse 400 L dhe 45 L, për fermer.		33,600.00							
048	1	3	6	22	Furnizim me shkumsa,shpuza dhe material didaktik për Shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Vitisë	29.08.2022	4,800.00	4,697.40	0.00	INFINITT	Prishtine			
049	5	2	1	45	Asfaltimi i rrugës Viti-Silatine e Ulët - (Faza e dytë) -Ritender.	20.09.2022	390,000.00	544,251.89	0.00	RAHOVICA COMERCE	Ferizaj			
050	5	2	1	45	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës,rruga Anton Çeta deri te rruga Sejdiu në fshatin Stubëll e Epërme, Viti-Faza e II-të - Ritender.	26.09.2022	550,000.00	822,858.14		PRO CO GROUP	Viti			
051	2	2	1	98	Shërbimet e trajtimit të qenëve ëndacak në komunën e Vitisë	22.09.2022	17,500.00	17,150.00	0.00	NAZIM KURTESI B.I	Viti			
052	5	1		45	Renovimi dhe zgjerimi i rrugës 'Kongresi i Manastirit' Viti - Faza e II (dytë).	29.09.2022	590,000.00	569,724.50	0.00	BERISHA COMPANY	Ferizaj			

053	2	3	6	63	Transporti i nxansave ne relacionin Podgorc-Viti dhe anasjelltas	02.09.2022	5,700.00	6,269.90	0.00	VALMIR SAHITI B.I	Viti			
054	2	3	6	63	Transporti i nxansave ne relacionin Letnicë-Stubell dhe anasjelltas	02.09.2022	4,200.00	6,370.00	0.00	BENI COMERCE	Viti			
055	1	2	1	21	Furnizimi me letër për administratën e komunës	07.09.2022	17,100.00	18,354.00	0.00	NSH BLENDI	Prishtine			
056	5	5	8	30	Furnizim me pajtje të Teknologjisë Informative. Marrveshja komizë sipas AQP-së	07.09.2022	16,100.00	13,692.00	0.00	ARITECH	Prishtine			
057	2	1	1	93	Shërbimet e energjisë për komunën e Vitisë (ESCO) sipas UA 06/2021.		3,100,000.00							
058	2	1	1	93	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeçare		140,000.00							
059	1	2	1	31	Furnizimi me Gjenerator për objektin e ri të Komunës së Vitisë		23,000.00							
060	1	2	1	34	Furnizimi me shpërndarëse plehu dhe grabuja për bujqit		41,300.00							
061	1	2	1	29	Furnizimi me Makina Mjelëse dhe Inkubator		17,600.00							
062	1	2	1	36	Furnizimi me koshere të bletëve		18,000.00							
065														
066														
067														
068														
069														
070														

